



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 59, pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/2. Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës së regjistruar dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.”.

Neni 2

Në nenin 120 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Subjektet e përmendura në pikën 1/2, të nenit 59, të ligjit, në rastin kur nuk disponojnë llogari bankare për transaksionet që kryejnë, dënohen, si më poshtë vijon:

- a) Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;
- b) Tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;
- c) Organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Nëse subjekti nuk ka llogari bankare për transaksionet që kryen edhe pas dënimit si më sipër, dënohet me dyfishin e gjobës së parë.

Subjektet e regjistruara rishtas duhet të hapin llogarinë bankare jo më vonë se 20 (njëzet) ditë kalendarike pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

Subjektet që janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit /administratën tatimore duhet të hapin llogarinë bankare jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R

GRAMOZ RUÇI